

KOMISARI I GARAVE

# BULETINI

## Nr. 2

8/20/2019

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 2-të e Komisarit të garave për edicionin 2019/20 mbajtur me 20.08.2019 në lokalët e FHK-së me fillim nga ora 12:00.

### REND DITE

1. Publikimi i vendimit të Bordit të FHK-së.
  - Kuotizimi për edicionin 2019/20.
2. Dhënia (dërgimi) i Propozicioneve të garave për edicionin 2019/20, klube, shoqatave, personave zyrtar etj.
3. Dhënia (dërgimi) i Propozicioneve të Kupës së Republikës së Kosovës për edicionin 2019/20, klubet, shoqatat, personat zyrtar etj.
4. Dhënia (dërgimi) i Propozicioneve të Grupmohave të reja për edicionin 2019/20.
5. Tërheqjes së shortit për edicionin 2019/20 në Superligën e meshkujve dhe femrave.
6. Informatë për seminarin qendror tematik si dhe testimet e SHGJHK-së për edicionin 2019/20.
7. Informatë për seminarin qendror të SHTHK-së për edicionin 2019/2019.
8. Te ndryshme.

-|-

1. Bordi i FHK-së në mbledhjen e mbajtur më 14.08.2019 mbështetur në propozicioneve e garave të edicionit 2019/20 morri këto:

### VENDIME

- a) Bordi me qëllim të ndihmon klubet morri vendim që Kotizimi për edicionin 2019/20 të jetë si vijon:
  - 1500 euro Superliga e meshkujve, nga të cilat FHK-ja mbulon 500 euro, kurse klubet do të paguajnë 1000 euro në dy këste vjeshtë dhe pranverë nga 500 euro.
  - 750 Superliga e femrave, nga të cilat FHK-ja mbulon 250 euro, kurse klubet do të paguajnë 500 euro në dy këste, vjeshtë dhe pranverë nga 250 euro.
  - 400 euro Liga e parë e meshkujve, nga të cilat FHK-ja mbulon 200 euro, kurse klubet do të paguajnë 200 euro në dy këste, vjeshtë dhe pranverë nga 100 euro.
  - 200 euro Liga e parë e femrave, nga të cilat FHK-ja mbulon 100 euro, kurse klubet do të paguajnë 100 euro në dy këste, vjeshtë dhe pranverë nga 50 euro.
- b) Bordi i FHK-së në mbledhjen e mbajtur me datën 14.08.2019 pasi morri shkresën e KH Dukagjini mbi tërheqjen nga garat e Superligës së meshkujve, unanimisht morri vendim që vendin e zbrazet në Superligë të plotësohet me KH Prizrenin, klub i cili për nga niveli organizativ, infrastrukturual dhe garantimit të pjesës financiare nga përgjegjësit komunal i plotëson të gjitha kriteret të jetë anëtarë i Superligës së meshkujve.

### ARSYETIM

Bordi në mbledhje mori vendim që në këtë edicion klubet të lirohen pjesërisht nga shuma plotë e kuotizimit. Gjithashtu pas tërheqjes së KH Dukagjini nga garat e Superligës morri vendim si në dispozitiv.

Deri të ky vendim erdhi me qëllim të ndihmës dhe mbështetjes për zhvillimin e garave duke pasur parasysh kushtet e rënda në të cilat po veprojnë klubet e hendbollit, me shpresë se klubet do të mobilizohen dhe të ngritët cilësia.

## -II-

Në këtë link keni të bashkangjitur Propozicionet të garave për edicionin 2019/20 pas miratimit të Bordit të FHK-së me datën 14.08.2019:

[http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/02-12-2014/316703\\_PROPOZICIONET\\_E\\_GARAVE\\_EDICIONI\\_2019-20.pdf](http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/02-12-2014/316703_PROPOZICIONET_E_GARAVE_EDICIONI_2019-20.pdf)

## -III-

Në këtë link keni të bashkangjitur Propozicionet të Kupës së Republikës së Kosovës për edicionin 2019/20 pas miratimit të Bordit të FHK-së me datën 14.08.2019:

[http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/29-12-2014/354172\\_PROPOZICIONET\\_E\\_GARAVE\\_PER\\_KUPEN\\_E\\_REPUBLIKES\\_SE\\_KOSOVES\\_2019-20.pdf](http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/29-12-2014/354172_PROPOZICIONET_E_GARAVE_PER_KUPEN_E_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_2019-20.pdf)

## -IV-

Në këtë link keni të bashkangjitur Propozicionet e grupmohave të reja për edicionin 2019/20 pas miratimit të Bordit të FHK-së me datën 14.08.2019:

[http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/13-02-2018/645500\\_Propozicionet\\_e\\_garave\\_per\\_grupmoshat\\_e\\_reja\\_edicioni\\_2019-20.pdf](http://kosovahandball.info/Articles/10/Images/13-02-2018/645500_Propozicionet_e_garave_per_grupmoshat_e_reja_edicioni_2019-20.pdf)

## -V-

Komisari e garave pas miratimit dhe caktimit të datës së fillimit të Edicionit 2019-20 dhe duke u mbështetur në nenin 4.10 të Propozicioneve të garave i **INFORMON** klubet se shorti për edicionin e ri të garave 2019/20 për Superligën e meshkujve, Superligën e femrave, Ligën e kadetëve dhe Ligen e kadeteve do të bëhet me datën **23 gusht 2019 në lokalet e FHK-së** me fillim nga ora **12:00** sipas sistemit të Bergerit.

## -VI-

**Komisari i garave** informon që seminarin qendror i SHGJHK-së dhe testimet teorikë para fillimit të edicionit 2019/20 do të mbahet 08 shtator 2019 në Prishtinë, ku do të ligjërojë lektori nga Federata Evropiane z. Dragan Nacevski një herit edhe përgjegjës për gjyqtar pranë EHF-së. Programin e seminarit do tju dërgojmë me kohë.

Obligohen tubimet Komunale të Gjyqtarëve që ti dërgojnë listat me propozimet e tyre për gjyqtarë dhe vëzhgues –kontrollues deri me 26.08.2019. Listat me propozimet e tyre duhet të dërgohen në email adresën [shgjhk@kosovahandball.info](mailto:shgjhk@kosovahandball.info).

Gjithashtu gjyqtarët dhe vëzhguesit të cilët kanë plotësuar kushtet dhe dëshirojnë të anësohen në kategori, janë të obliguar që deri me datën 26.08.2019 ti dërgojnë kërkesat dhe ti përmbushin obligimet sipas Rregullores për avancimin e përparimin e anëtarëve të SHGJHK-së.

## **-VII-**

**Komisari i garave** informon se seminari qëndro tematik dhe praktik i SHTHK-se para fillimit të edicionit 2019/20, do të mbahet me datën 07.09.2019 (e shtunë) ne Palestrën e Sporteve “Adem Jashari” në Obiliq ku ligjërues i këtj seminari do të jetë lektorja nga Kroacia **Lidija Bojic-Cacic** një herit lektore e licencuar edhe pran Federatës Evropiane të Hendbollit. Gjithashtu në këtë seminar do te behet edhe licencimi i trajnerëve.

**Istref SADIU**  
**KOMISAR I GARAVE d.v**